

Statistikat afatshkurtra*


Prodhuesit e të mirave - Tremujori I, 2017

Tiranë, më 14 Qershor: Treguesit kryesorë tremujorë mbi prodhuesit e të mirave, të cilat përfshijnë aktivitetet ekonomike: industri (industri nxjerrëse dhe industri përpunuese); energji elektrike, gaz, avull; furnizimi me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve; ndërtim, në tremujorin e parë 2017 (periudhë bazë 2010=100), paraqiten si më poshtë:

Industri

- Indeksi i shitjeve neto në volum u rrit 9,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky tregues i përshtatur sezonalisht shënoi rritje 9,9 %, krahasuar me tremujorin paraardhës;
- Indeksi i prodhimit në volum u rrit 13,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërsa krahasuar me tremujorin paraardhës, ky tregues i përshtatur sezonalisht shënoi rënie 2,5 %;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rënie me 2,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Krahasuar me tremujorin paraardhës, ky tregues i papërshtatur sezonalisht shënoi rënie 1,2 %;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rënie me 0,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Krahasuar me tremujorin e katërt 2016, ky tregues i papërshtatur sezonalisht shënoi rënie 4,1 %.

Fig.1 Indeksi i shitjeve neto në volum në Industri




* INSTAT, duke filluar nga tremujori i parë 2017, ka përditësuar serinë kohore të treguesve të statistikave afatshkurtra, prodhues të të mirave (në vlerë dhe volum), mbështetur në ndryshimin e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara në vitin 2015. Gjithashtu, seria kohore e treguesve paraqitet për herë të parë e përshtatur sezonalisht. (për më tepër shih: shënime metodologjike fq.7)

Energji elektrike, gaz, avull

Indekset e treguesve kryesorë në statistikat afatshkurtra në aktivitetin energji elektrike, gaz, avull në tremujorin e parë 2017 (periudhë bazë 2010=100), paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum u ul 15,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky tregues i përshtatur sezonalisht shënoi rënie 5,1 % krahasuar me tremujorin paraardhës;
- Indeksi i prodhimit në volum u ul 28,0 %, krahasuar me tremujorin e parë 2016. Krahasuar me tremujorin paraardhës, ky tregues i përshtatur sezonalisht shënoi rënie 62,5 %;
- Indeksi i numrit të të punësuarve u ul 2,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Krahasuar me tremujorin e katërt 2016, ky tregues i papërshtatur sezonalisht shënoi rënie 0,5 %;
- Indeksi i fondit të pagave u rrit 7,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërsa, ky tregues i papërshtatur sezonalisht shënoi rënie me 10,2 %, krahasuar me tremujorin paraardhës.

Fig.2 Indeksi i shitjeve neto në volum në Energji elektrike, gaz, avull




Furnizimi me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve

Indekset e treguesve kryesorë në statistikat afatshkurtra në aktivitetin furnizimi me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve, në tremujorin e parë 2017 (periudhë bazë 2010=100), paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie me 3,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky tregues i përshtatur sezonalisht shënoi rënie me 9,9 %, krahasuar me tremujorin paraardhës;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje me 4,9 %, krahasuar me tremujorin e parë 2016. Ndërsa krahasuar me tremujorin paraardhës, ky tregues i përshatur sezonalisht shënoi rënie 9,2 %;

- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje me 11,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërsa, krahasuar me tremujorin e katërt 2016, ky tregues i papërshtatur sezonalisht shënoi rritje me 5,3 %;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 12,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërsa, ky tregues i papërshtatur sezonalisht shënoi rënie me 0,3 % krahasuar me tremujorin paraardhës.

Fig.3 Indeksi i shitjeve neto në volum në Furnizimin me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve;




Ndërtim

Indekset e treguesve kryesorë në statistikat afatshkurtra në aktivitetin ndërtim, në tremujorin e parë 2017 (periudhë bazë 2010=100), paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum u rrit 13,6 %, krahasuar me tremujorin e parë 2016. Krahasuar me tremujorin paraardhës, ky tregues i përshtatur sezonalisht shënoi rritje me 1,3 %;
- Indeksi i prodhimit në volum u rrit 24,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërsa, krahasuar me tremujorin paraardhës, ky tregues i përshtatur sezonalisht shënoi rritje 3,6 %;
- Indeksi i numrit të të punësuarve u rrit 3,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërsa, ky tregues i papërshtatur sezonalisht krahasuar me tremujorin paraardhës, u ul me 1,0 %;
- Indeksi i fondit të pagave u rrit 9,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky tregues i papërshtatur sezonalisht shënoi rritje 6,7 %, krahasuar me tremujorin paraardhës.

Fig.4 Indeksi i shitjeve neto në volum në Ndërtim



Tab.1 Indeksi i shitjeve neto, në volum, në prodhuesit e të mirave (2010=100), i papërshtatur sezonalisht

NVE Rev.2			Tr.1.17	I - 17	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Ø 2010	I - 16	IV - 16
B-C	05-33	Industri	103,9	9,4	-8,2
B	05-09	Industri nxjerrëse	143,5	35,1	2,6
C	10-33	Industri përpunuese	100,9	0,2	-12,9
D	35	Energji elektrike, gaz, avull	150,3	-15,8	6,6
E	36-39	Fumizimi me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve	150,0	-3,6	-23,0
F	41-43	Ndërtim	91,5	13,6	-28,5
Grupimet industriale kryesore					
		Mallra të ndërmjetme	118,6	27,9	-7,9
		Energji	111,3	-0,8	8,1
		Mallra kapitale	146,2	13,9	-13,8
		Mallra të qëndrueshme konsumi	99,9	-21,5	-53,4
		Mallra të paqëndrueshme konsumi	122,3	-1,7	-11,3

Tab.2 Indeksi i shitjeve neto, në volum, në prodhuesit e të mirave (2010=100), i përshtatur sezonalisht

(%)

NVE Rev.2		Aktiviteti ekonomik	Tr.1.17	I - 17	I - 17
Seksioni	Ndarja		Ø 2010	I - 16	IV - 16
B-C	05-33	Industri	119,0	8,8	9,9
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	172,0	25,3	28,9
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	112,2	0,4	0,5
D	35	Energji elektrike, gaz, avull	134,4	-15,9	-5,1
E	36-39	Furnizimi me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve	167,6	-2,8	-9,9
F	41-43	Ndërtim	107,8	14,0	1,3
Grupimet industriale kryesore					
		Mallra të ndërmjetme	137,2	26,0	12,7
		Energji	104,5	-0,5	2,5
		Mallra kapitale	171,9	13,9	18,4
		Mallra të qëndrueshme konsumi	118,2	-21,1	-34,3
		Mallra të paqëndrueshme konsumi	133,4	-1,2	-2,8

Tab.3 Indeksi i Prodhimit, në volum, në prodhuesit e të mirave i papërshtatur sezonalisht (2010=100)

(%)

NVE Rev.2		Aktiviteti ekonomik	Tr.1.17	I - 17	I - 17
Seksioni	Ndarja		Ø 2010	I - 16	IV - 16
B-C	05-33	Industri	134,6	13,4	-5,4
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	163,7	35,1	7,2
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	100,8	-0,7	-14,5
D	35	Energji elektrike, gaz, avull	134,1	-28,0	-19,5
E	36-39	Furnizimi me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve	119,6	4,9	-18,8
F	41-43	Ndërtim	95,7	24,2	-25,8

Tab.4 Indeksi i Prodhimit, në volum, në prodhuesit e të mirave i përshtatur sezonalisht (2010=100)

(%)

NVE Rev.2		Aktiviteti ekonomik	Tr.1.17	I - 17	I - 17
Seksioni	Ndarja		Ø 2010	I - 16	IV - 16
B-C	05-33	Industri	136,2	7,9	-2,5
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	152,2	22,5	-0,3
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	120,7	-0,4	-2,6
D	35	Energji elektrike, gaz, avull	82,0	-27,8	-62,5
E	36-39	Furnizimi me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve	128,6	4,8	-9,2
F	41-43	Ndërtim	110,8	15,7	3,6

Tab.5 Indeksi i numrit të të punësuarve i papërshtatur sezonalisht, në prodhuesit e të mirave (2010=100)

(%)

NVE Rev.2		Aktiviteti ekonomik	Tr.1.17	I - 17	I - 17
Seksioni	Ndarja		Ø 2010	I - 16	IV - 16
B-C	05-33	Industri	139,0	-2,2	-1,2
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	100,3	1,4	0,4
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	145,9	-2,7	-1,5
D	35	Energji elektrike, gaz, avull	112,6	-2,0	-0,5
E	36-39	Fumizimi me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve	149,0	11,6	5,3
F	41-43	Ndërtim	124,5	3,0	-1,0

Tab.6 Indeksi i fondit të pagave i papërshtatur sezonalisht, në prodhuesit e të mirave (2010=100)

(%)

NVE Rev.2		Aktiviteti ekonomik	Tr.1.17	I - 17	I - 17
Seksioni	Ndarja		Ø 2010	I - 16	IV - 16
B-C	05-33	Industri	166,7	-0,1	-4,1
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	181,4	14,2	-3,0
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	159,1	-5,7	-3,7
D	35	Energji elektrike, gaz, avull	142,2	7,1	-10,2
E	36-39	Fumizimi me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve	165,7	12,3	-0,3
F	41-43	Ndërtim	151,8	9,9	6,7

Shënime Metodologjike

Informacion

INSTAT publikon për tremujorin e parë 2017, Indekset e prodhuesve të të mirave ku përfshihen: industria (industri nxjerrëse dhe industri përpunuese); energji elektrike, gaz, avull; furnizimi me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve; ndërtim, me disa përditësime metodologjike, si:

- Përditësimi i serive kohore të treguesve të prodhuesve të të mirave materiale (në vlerë dhe volum), mbështetur në ndryshimin e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara në vitin 2016.
- Përshtatja sezonale e serive kohore

INSTAT publikon në 2017, Politikën e Revizionimit Statistikor në linkun: (http://www.instat.gov.al/media/371719/politika_e_revizionimit.pdf);

Procesi i përditësimit

Në vitin 2016 numri i ndërmarrjeve aktive (jobujqësore) në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve u rrit me 20 %, të madhësisë së popullatës në fushën e mbulimit në vërtetimin mbi njësitë e prodhimit të të mirave materiale.

Si rrjedhojë e sa më sipër, u krye përditësimi i serive kohore të të dhënave në nivel individual, si edhe peshave përkatese në nivel të grupuar. Nga këto ndryshime niveli i të dhënave ndryshon, por norma vjetore e ndryshimit mbetet pothuaj e pandryshuar.

Procesi i përditësimit është bërë përmes benchmarkimit të të dhënave të përfuara nga Rregjistri Statistikor i përditësuar, 2015, me metodën e shpërndarjes proporcionale (metoda Denton).

Përshtatja sezonale

Përshtatja sezonale në seritë tremujore të prodhimit të të mirave materiale u zbatua duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.1.0. Modeli i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspesifikimin X-13 në serinë kohore Tremujori I 2005 - Tremujori I 2017. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme. Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishitë (multiplikative). Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale në pasqyrimin e statistikave afatshkurtra. Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.

Informacion mbi vrojtimin

Qëllimi - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

Në prodhuesit e të mirave:

Fusha e mbulimit - Bazuar në aktivitetin kryesor, në anketën tremujore pranë ndërmarrjeve janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Industri, e cila përbëhet nga Industria Nxjerrëse dhe Përpunuese (05 – 33)
- Energji elektrike (35)
- Furnizimi me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve (36-39)
- Ndërtim (41, 42, 43)

Modeli - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku kampioni për ndërmarrjet me 1 - 9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

Mbledhja e informacionit - Mbledhja e të dhënave bëhet me intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2010=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor.

Ndryshimi vjetor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur , etj.

Përkufizimet e treguesve kryesorë

Shitjet neto - *Shitjet neto* përfshijnë shumat e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korrespondon me tregun e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar.

Indeksi i shitjeve neto - Objektivi i indeksit të *shitjeve neto* është të paraqesë ecurinë e tregut për mallra dhe shërbime.

Numri i të punësuarve me pagesë - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përfshijtur të vetëpunësuarit me pagesë).

Paga dhe trajtime - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimit (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese.

Indeksi i fondit të pagave - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuar, nga njëra periudhë në tjetrën.

Grupimet Industriale Kryesore janë një rigrupim i aktiviteteve Industri Nxjerrëse, Industri Përpunuese dhe Energji të detajuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2), si më poshtë:

Grupimet Industriale Kryesore	NVE Rev.2
Mallra të ndërmjetme	<ul style="list-style-type: none"> • 07-09 Nxjerrja e mineraleve natyrore; Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat; Aktivitete mbështetëse minerare • 13000 Përpunimi i tekstileve • 16000 Prodhimi i drurit dhe materialeve prej druri, përveç mobiljeve • 17000 Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrë • 20-21 Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike; Përpunimi i produkteve farmaceutike • 22000 Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës • 23000 Prodhimi i produkteve minerale jo metalike • 24000 Metalurgjia • 255XX Farkëtimi, stampimi, petëzimi dhe trafilizimi i metaleve • 27000 Prodhimi i pajisjeve elektrike
Energji	<ul style="list-style-type: none"> • 05-06 Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve; Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror • 19000 Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës • 35000 Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri i kondicionuar
Mallra kapitale	<ul style="list-style-type: none"> • 251XX Prodhimi i produkteve metalike strukturore • 262XX Prodhimi i kompjuterave dhe pajisjeve periferike • 28000 Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p.k.t • 33000 Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve
Mallra të qëndrueshme konsumi	<ul style="list-style-type: none"> • 264XX Prodhimi i produkteve elektronike për konsumatorët • 31000 Prodhimi i mobiljeve • 32XXX Industri të tjera p.k.t
Mallra të paqëndrueshme konsumi	<ul style="list-style-type: none"> • 10000 Përpunimi i produkteve ushqimore • 11-12 Prodhimi i pijeve; Prodhimi i produkteve të duhanit • 14000 Konfeksionimi i veshjeve • 15000 Prodhimi i lëkures dhe produkteve prej lëkure • 18000 Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara • 32YYY Industri të tjera p.k.t